

Data 10.05.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

-"Ndërtim i Rrjetit të Ri të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza të Lagjes Uznovë,Rajoni Nr.3 Bashkia Berat"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 45000000-7 – Punë ndërtimi ,45232400-6 Punime ndërtimi për kanalizime

VLERA E FONDIT LIMIT:

-191,978,878 .85 (Njëqind e nëntëdhjetë e një milion e nëntëqind e shtatedhjetë e tete mijë e teteqinde e shtatedhjetë e tete pike tetedhjetë e pese) leke pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 "Për prokurimin publik", Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", njesia e prokurimit prane autoritetit kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Berat**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është deri në kufirin e lartë monetar.

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetar janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650.000.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 40.000.000 (Dyzet milion) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas percaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1 Shtojca 7.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022,2023 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen (*elementët konkretë*) dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 dhe për tremujorin e parë të vitit 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter të përmbushet nepermjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8 të DST. Nëse operatori ekonomik kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia / Komuna me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetedeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**;...3) Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin **informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko -financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Gjithashtu, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018** “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministripërgjegjës për financat”.

Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gëzojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021, 2022, 2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Gjithashtu njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjisllacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

❖ Kriteret e kapacitetit teknik të mëposhtme nga pika 2.3.1 deri në pikën 2.3.9, janë hartuar dhe argumentuar nga specialistët e fushës, të cilët janë pjesë përbërse e njësisë së prokurimit të procedurës, duke u administruar në dosjen e procedurës së prokurimit, procesverbali i hartimit dhe argumentimit të kriterëve të kapacitetit teknik i nënshkruar , nga to në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 2 të nenit 74 dhe në pikën 2 të nenit 78 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik e ndryshuar, si dhe njoftimit Nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a.** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b.** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;

- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
 - Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqeruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt Kolaudimi
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe

- Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatoreve.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - a. Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor dhe
 - b. Miratimin zyrtar si nënkontraktorit nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme** për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të**

kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektivit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe *formular vleresimi për punët e kryera me entet publike*, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqenese se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave

Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria NP-1** Punime germimi në toke **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP-4** Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai..... **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi D**
- **Kategoria NP-12** Punime të inxhinierise së mjedisit **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 1** Punime për prishjen e ndërtimeve **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi B**

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42 datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.***

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet: “Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara **sipas llojit dhe nënlojit** të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Konkretisht Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar :

Kategoria N.P - 1 “Punime gërmimi në tokë” *Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Duke qene se nga perlllogaritjet e preventivit shume volume punimesh jane germime dheu me krah dhe me makineri, perforcime germimi mbushje kanali, etj, te cilat do te kryhen me qellim shtrimin e tubacioneve KUZ, dhe nderkohe kjo kategori punimesh perfshin germime dheu, mbushje e ngjeshje, sistemim te tokes apo tereneve te tjera ku do kaloje projekti, per kete arsye eshte kerkuar qe OE te kete ketë kategori license.

Kategoria N.P-4 “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të **thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe nëlartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro,**

hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderrur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet zërave të parashikuara në preventivin e objektit ne te cilin do te ketë nderhyrje ne rruge, punime, prerje asfalti, shtrese asfalto beton, prishje pllaka, asfaltime, etj, si dhe referuar Specifikimeve Teknike dhe Relacionit teknik, ku parashikohet se **rruget ne te cilat do te realizohen nderhyrjet, pas perfundimit te punimeve per KUZ do te kthehen ne gjendjen e meparshme.**

Ne relacionin teknik referohet: “Ndertimi i rrjetit te kanalizimeve do te realizohet ne funksion te objekteve te banimit Lagjes Uznove , Njesia Administrative Nr.3, Bashkia Berat. Rrjeti i ri do te ndertohet duke shfrytezuar rruget e ekzistuese te qytetit. Ndertimi i rrjetit te KUZ qe perfshin trasimin e linjes se magjstralit kryesor dhe sekondar eshte sipas planit me te pershtatshem urbanistik duke shmangur sa me shume edhe prishjet ne rruget kryesore dhe carjet ne trup rruge. Ne planimetri jane shenuar te gjitha ndertesat ekzistuese, rruget, sheshet dhe pika me ulet e shkarkimit ne te cilin do te shkarkohen kanalizimet qe do i drejtoje drejt rrjetit kryesor te qytetit”.

Ne **specifikimet teknike** percaktohet: “Punimet në rrugë dhe trotuare, Puna në rrugë në kantier do të kryhet në seksione të tilla që gjatësia e rrugës e zënë në çdo kohë nuk e kalon atë të shprehur në kontratë dhe gjerësia e rrugës e zënë në çdo kohë nuk e kalon gjerësinë e një vije kalimi përveç se kur lejohet nga Mbikqyrësi dhe Autoritetet Lokale. Puna në çdo seksion do të përfundojë dhe rruga do të rivendoset dhe të hapet për trafikun para fillimit të punimeve në seksionin tjetër. Puna në çdo seksion, duke përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin, do të kryhen në mënyrë të tillë që trafiku dhe shërbimet në rrugët e afërta dhe trotuaret të qëndrojnë në mënyrë adekuate”

Si dhe: Rrugët, trotuaret dhe objektet e tjera të ndikuara nga rregullimi dhe kontrolli i përkohshëm i trafikut do të rivendosen në gjendjen ekzistuese para fillimit të punimeve ose në një gjendje tjetër që mund të jetë miratuar ose udhëzuar nga Mbikqyrësi. Duke patur parasysh keto punime qe do realizohen ne rruget qe pershkon projekti, eshte kerkuar qe OE te kete kete kategori license.

Kategoria N.P-7 “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje” *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionete pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

Kjo kategori licence i referohet se pari objektit të kontratës dhe se dyti punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht furnizim vendosje tuba KUZ , furnizim vendosje puseta kontrolli, etj.

Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori license është vendosur duke patur parasysh se punimet duhet të kryhen me kujdes për të mos prishur strukturën e tokës, rehabilitimi i tokës do të kryhet pas punimeve të ndërtimit si edhe depozitimi i mbetjeve nga germimet apo prishjet në vendodhjet e percaktuara.

Sipas parashikimit në specifikimet teknike “Punimet do të kryhen në një mënyrë të tillë që, për aq kohë sa të jetë e arsyeshme dhe praktike, të mos ketë dëmtime ose të mos ndërhyhet në sa më poshtë, me përjashtim të dëmeve të tilla që kërkohen për ekzekutimin e punimeve: a) Rrjedhat e ujërave dhe sistemet e kullimit, b) Shërbimet, c) Strukturat, rrugët duke përfshirë objektet e vendosura në to, ose prona të tjera, d) Mjete publike ose private ose kalime këmbësorësh, dhe Peme, varre dhe varreza

Qëllimi i këtij projekti i cili është ndërtimi i Rrjetit KUZ si dhe grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura, nëpërmjet kolektorit kryesor. Duke qenë se kemi të bëjmë me rrjet të kanalizimeve të ujërave të zeza të cilat janë specifike, konkludohet se të gjitha këto elemente kanë ndikim dhe impakt në mjedis ndaj është e domosdoshme që OE të ketë kategori license Kategoria NP-12.

Kategoria N.S- 1 Punime për prishjen e ndërtimeve .

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Gjate punimeve te parashikuara ne preventiv ka zera per prishje strukturash b/a si dhe rruge , rrjet e puseta ekzistuese .

Kategoria NS 18 Punime topogjeodezike. Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar *zbatimin e* rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në pëputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektin e zbatimit dhe parashikohen ne preventivin e punimeve.

Konkretisht kjo kategori licence eshte e domosdoshme per piketimet e kanaleve qe do te germohen dhe sistemimeve topografike. Eshte kerkuar sipas parashikimeve ne relacionin teknik dhe specifikimet teknike.

Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kerkuar bazur ne zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave te kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, te ndryshuar.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. B	Punime gërmimi në tokë	3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.87/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke 3.45/1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	21-51 mln leke	38.425.589

N.P-4 A	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	3.158/5a Transport dheu me auto deri 5.0 km 3.158/5a Prishje rrjetit ekzistues 2.29 Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	0-20 mln leke	6.655.711,6
N.P-7 D	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	An.4-1 F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=200 mm per lidhjet terciare me shtepite An.4-2 F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d= 250 mm An.4-3 F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=315 mm 3.An/1t F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm 3.An/2t F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm 3.An/3t F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm An.6-5 Furnizim - Vendorsje puseta HDPE lartesi 3.0 - 3.5 m 3.717 Ndertim Pusete kryesore betoni 2x2 m kapak gize H=2.5-3.5 m 2.258 Nenshtrese zhavorri t=10cm (nen pusete)	101-200 mln leke	124.718.299
N.P-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	3.2 Prerje bime te vogla ø-10cm 3.3 Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm 2.261 Shtrese rere per tubacionet An.2-1 Mbushje me material te germuar, perhapur e ngjeshur me makineri ne tokat vegjetale 3.358 Nenshtrese zhavorri t=20cm	0-20 mln leke	3178778,84
N.S- 1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	4.190 Prerje shtrese asfalti ekzistues me makineri 3.969 Skarifikim shtrese asfalti me makineri tmes=6cm An.1-1 Heqje pllaka trotuari An.1-2 Prerje shtrese betoni nen trotuar me makineri 2.426/3 Prishje shtresa betoni 3.405/1 Prishje struktura prej betoni (puseta ekzistuese)	0-20 mln leke	9.865.070
N.S-18. B	Punime topogjeodezike	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	21-51 mln leke	

b) Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomike:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- **Certifikatë ISO 9001:2015 - Certifikim per menaxhimin e cilesise ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyre qe OE te siguroje një furnizim me cilesi dhe standarte europiane e cila duhet te jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar

ndër vite do te pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO; *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*

- **Certifikatë ISO 14001:2015 - Sistemi i Menaxherial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- **Certifikatë ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhen e realizimit të kontrates) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- **Certifikatë ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor) - ose ekuivalent**, e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e përkatëse.*
- **Certifikate ISO 1452-1:2009 “Per Sistemet e tubacioneve plastike per furnizimin me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nen presion” ose ose ekuivalent**, e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e përkatëse).*
- **Certifikate sistemi i menaxhimit të pergjegjesis shoqerore SA 8000:2014 ose ose ekuivalent**, e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili

ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e përkatëse).

(Të gjitha këto dokumenta Certifikata ISO duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht :

- **Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent,** na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë. Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:
 - duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
 - synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

- **Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent,** është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës.

Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- **Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent**, na shërben pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

- Kërkesa Lidhur me certifikimin **ISO 39001:2012** është vendosur si një standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.
- **ISO 1452-3:2009 ose ekuivalent** specifikon karakteristikat e pajisjeve të bëra nga poli(vinilklorid) i paplastifikuar (PVC-U) për sistemet e tubacioneve të destinuara për furnizimin me ujë dhe për kullimin dhe kanalizimin nën presion dhe mbi tokë. Ai gjithashtu specifikon parametrat e testimit për metodat e testimit të referuara. Është i zbatueshëm për pajisjet PVC-U dhe për nyjet me përbërës të PVC-U, materiale të tjera plastike dhe jo-plastike të destinuara për t'u përdorur për sa vijon :

- rrjetet e ujit dhe shërbimet e groposura në tokë;
- bartja e ujit mbi tokë për ndërtesat e jashtme dhe të brendshme;
- kullimi dhe kanalizimi i groposur dhe mbi tokë nën presion.

Zbatohet për pajisjet në sistemet e tubacioneve të destinuara për furnizimin me ujë nën presion deri në dhe duke përfshirë 25 °C (ujë i ftohtë), të destinuara për konsum njerëzor dhe për qëllime të përgjithshme, si dhe për ujërat e zeza nën presion. Është gjithashtu i zbatueshëm për komponentët për transportimin e ujit dhe ujërave të zeza deri në dhe duke përfshirë 45 °C

- **Certifikate sistemi i menaxhimit të përgjegjesis shqiptare SA 8000:2014 ose ose ekuivalent** përcakton pritjet minimale të performancës është një standard që përshkruan kushtet që duhet të përmbushen nga bizneset duke përfshirë krijimin ose permisimin e të drejtave të punonjësve, kushtet e punës dhe një sistem efektiv të menaxhimit. Cdo subjekt duhet të sigurojë një ambjent të drejtë pune dhe praktika transparente për menaxhimin e të drejtave të punonjësve dhe si rrjedhojë rezultatet cilësore në punë dhe zbatim kontratash pune.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt **,Inxhinier Hidroteknik** i cili duhet të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

(Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomike duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë që Drejtuesi Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë për sipas për qindjes së bashkpunimit).

Argumentimi: Është kërkuar nëpërmjet këtij kriteri përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik i drejtuesit teknik të punimeve si pjesë e personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e kontratës pasi drejtuesi teknik i punimeve do të jetë personi përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës referuar pika 2.1 të kreut I të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit. Ky kriter është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, pika 4.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 60 (gjashetdhjet) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik** si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale ose licens perkatese

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Drejtuesit Teknik te jene te përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes se tenderit, te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatori Ekonomik ofertues duhet që te kete te trajnuar te pakten 1 (një) drejtues teknik i pajisur me çertifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, per Drejtuesit Teknik duhet te dorezoje dokumentacionin:

c. Operatori Ekonomik per te realizuar objektin e prokurimit, duhet të ketë te punesuar per kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt, jo domosdoshmerisht te perfshire ne licensen e shoqerise, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes se tenderit, te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, stafin inxhinierik si me poshte:

Inxhinier Gjeodet 1 (nje)

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;

Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, per stafin e inxhinierëve te sipercituar, duhet te dorezoje dokumentacionin:

d. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik te perbere nga te pakten **24** (Njezete e kater) punonjes te specializuar dhe te certifikuar sipas profesionit qe kryejne dhe te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë për periudhen të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit, me profesionet si me poshte:

- **3 (tre) Hidraulike**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara ose dëshmi kualifikimi nga subjektet juridike private te akredituara per certifikimin punonjesve.
- **3 (tre) Teknike ndertimi**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara ose dëshmi kualifikimi nga subjektet juridike private te akredituara per certifikimin punonjesve.
- **3 (tre) punonjes te specializuar per shtrim asfalti**, te shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara ose dëshmi kualifikimi nga subjektet juridike private te akredituara per certifikimin punonjesve.
- **3 (tre) punonjes te specializuar per shtrim pllaka** shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara ose dëshmi kualifikimi nga subjektet juridike private te akredituara per certifikimin punonjesve.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) te pjesëmarrjes së tyre në bashkim sipas kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

- **Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:**

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate.
- Diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Për specialistet e mesiperm (*me përjashtim të punonjësve shofere*) të paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8734 datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

e. Operatori Ekonomik duhet të ketë të pakten :

- **5 (pese) Manovratore dhe**
- **5 (pese) drejtues mjetesh(shofer) kategoria C minimale**

Te cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Kontratë pune / shërbimi të vlefshme;
- Leje drejtimi mjeteve kategoria C minimale
- Certifikatë e Aftësisë Profesionale (shoferet), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit

f. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimit si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomikë duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike,** si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar

objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) fuqinëpunëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Gjithashtu, me qëllim ndërtimin e objektit të vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 60 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit si dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit prej periudhën 12 muaj duke përfshirë këtu numrin total të punonjësve inxhinierë, teknike, specialiste, punonjës të kualifikuar dhe punetore për punime me krahe, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj. Duke qënë se ky objekt përfshin rrjetin e kanalizimeve të ujerave të ndotura si dhe duke u bazuar në grafikun e punimeve, lind nevoja për këtë fuqi të përcaktuar punetore. Nr. i punonjësve pa përfshirë stafin teknik është llogaritur në bazë të orëve të punës sipas preventivit .

NR.	ANALIZE	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	OP/Njesi	OP
1	3.2	Prerje bime te vogla ø-10cm	m2	1700	0,08	136
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm	cope	12	0,4	4,8
3	4.190	Prerje shtrese asfalti ekzistues me makineri	ml	6090	0,7	4263
4	3.969	Skarifikim shtrese asfalti me makineri tmes=6cm	m2	3015	0,048	144,72
5	An.1-1	Heqje pllaka trotuari	m2	1040	0,35	364
6	An.1-2	Prerje shtrese betoni nen trotuar me makineri	ml	1730	0,45	778,5
7	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	62	18,8	1165,6
8	3.405/1	Prishje struktura prej betoni (puseta ekzistuese)	m3	125	1,75	218,75
9	An.1-3	Prishje rrjetit ekzistues	ml	2641	0,75	1980,75
10	3.158/5a	Transport me auto deri 5.0 km	m3	431	0	0
11	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	9872	0,109	1076,048
12	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	9938	0,094	934,172
13	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m²	m3	655	6,04	3956,2
14	2.261	Shtrese rere per tubacionet	m3	2100	2,175	4567,5
15	An.2-1	Mbushje me material te germuar, perhapur e ngjeshur me makineri ne tokat vegjetale	m3	9937	0,34	3378,58
16	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	9129	0,025	228,225
17	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	10498	0	0
18	2.258	Nenshtrese zhavorri t=20cm	m3	201	2,9	582,9
19	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15(nen trotuar t=10cm)	m3	101	8,6	868,6
20	An.3-1	Vendosje pllaka trotuari	m2	1040	1,1	1144
21	2.29	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	ml	78	0,028	2,184
22	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	3015	0,28	844,2
23	3.212/c	Shtrese stabilizant t=10-15cm	m2	3015	0,1	301,5
24	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm,me makineri	m2	3015	0,12	361,8
25	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	3015	0,095	286,425
26	An.4-1	F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=200 mm per lidhjet terciare me shtepite	ml	9540	1,2	11448
27	An.4-2	F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d= 250 mm	ml	1665	1,4	2331
28	An.4-3	F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=315 mm	ml	2689	1,5	4033,5
29	3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	3380	1,5	5070
30	3.An/2t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml	986	1,78	1755,08
31	3.An/3t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm	ml	281	2,04	573,24
32	3.An/4t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=600 mm	ml	75	2,14	160,5
33	3.An/5t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=800 mm	ml	1005	2,24	2251,2
34	4.60/1	F.V. tuba celiku ø>200 te h/izoluuar ne fabrike	ton	2,92	28,1	82,052
35	4.141/a7,0	F.V. shirit sinjalizimi	ml	19621	0,04	784,84
36	3.59/b	Germim themel i vecuar, gropa sip.10-30 m², toke e zak. me h = 1.5 m	m3	3270	4,94	16153,8
37	2.258	Nenshtrese zhavorri t=10cm (nen pusete)	m3	28	2,9	81,2
38	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10 (nen pusete)	m3	28	8,6	240,8
39	3.393/1	Mbushje me zhavorr pas mureve pusetave	m3	1250	10,5	13125
40	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	3270	0,03	98,1
41	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=150, me kapak gize	cope	18	8,6	154,8
42	3.586	Ndertim Pusete kontrolli b/a, Ø1.0 m, h=1,5 ±2.0 m + kapak gize	cope	2	12,6	25,2
43	3.585	Ndertim Pusete kontrolli b/a,Ø1 m, h=2,0±2.5 m + kapak gize	cope	1	11,2	11,2
44	3.393	Ndertim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize	cope	1	8	8
45	An.6-1	Furnizim - Vendosje puseta HDPE lartesi 1.0 - 1.5 m	cope	243	6,7	1628,1
46	An.6-2	Furnizim - Vendosje puseta HDPE lartesi 1.5 - 2.0 m	cope	50	7,1	355
47	An.6-3	Furnizim - Vendosje puseta HDPE lartesi 2.0 - 2.5 m	cope	23	7,6	174,8
48	An.6-4	Furnizim - Vendosje puseta HDPE lartesi 2.5 - 3.0 m	cope	10	8,1	81
49	An.6-5	Furnizim - Vendosje puseta HDPE lartesi 3.0 - 3.5 m	cope	2	8,6	17,2
50	3.717	Ndertim Pusete kryesore betoni 2x2 m kapak gize H=2.5-3.5 m	cope	1	26	26
		Ore pune ne total per kryerjen e punimeve				88258.1
		Dite pune 8 orarshe ne total				11032.3
		Peruidha ne dite per kryerjen e punimeve sipas grafikut eshte 12 muaj				
		22 dite pune/muaj * 12 muaj				264
		Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve				42
		Numri i specialisteve te nevojshem				18
		Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve				60

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga

pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtröjmë:

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”.

Inxhinier Gjeodet / Topograf është përgjegjës për kontrollin e piketimeve të gërmimeve për realizimin e hapjes së kanalit. Gjithashtu edhe referuar relacionit teknik të objektit është përcaktuar: **Punimet duhet të zbatohen rreptësisht me inxhinier gjeodet ose topograf të licensuar për aftësitë e tij në punime zbatimi, sipas planimetrisë dhe profileve gjatësorë**, në prezencë të investitorit dhe supervizorit.

Si dhe specifikimeve teknike ku përcaktohet:

Punimet do të zbatohen **rreptësisht nën mbikqyrjen e një topografi dhe një inxhinieri hidroteknik**, sipas planimetrisë dhe profileve gjatësorë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit

Është kërkuar Inxhinier Mjedisi pasi:

Aktiviteti është menduar të kryhet në përputhje me kërkesat mjedisore, si dhe për ndërtimin e rrjetit KUZ i cili duhet të jetë në përputhje me kriteret për mbrojtjen e mjedisit pra për zbatimin e projektit nevojitet eksperiencia profesionale e Inxhinierit të Mjedisit.

Eshte kerkuar te kete ne staf edhe **Inxhinier Ndërtimi** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, rehabilitimin e rrugeve per ti kthyer ato ne gjendjen e meparshme funksionale si dhe kontrollit te punimeve te betonit te pranishme ne preventiv si: ndertim mure betoni prishje mure betoni, puseta beton arme, rikonstruksion pusete etj.

Eshte kerkuar punonjes i pajisur me Çertifikate Kompetence Profesionale ne transportin rrugor brenda dhe jashte vendit te mallrave, leshuar nga DPSHTRR, per arsye te sigurise dhe pergjegjesise rrugore te transportit te mallrave (tubove dhe vaskave biologjike) qe merren nga importi ose tregu vendas.

Në lidhje me kriterin për disponimin e numrit minimal prej 24 punonjës te specializuar dhe te certifikuar është një kërkesë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Referuar natyrës së punimeve, ku kryesisht kemi të bëjmë me punimet per KUZ, shtrirjen e tubave HDPE ,PE pergjate gjithë kesaj linje , kërkohet që këto punonjës të jenë me specialitetin hidraulik, ku referuar llojit të punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimitka përcaktuar kërkesat minimale për punonjësit e kualifikuar që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë për realizimin e ketij objekti.

Jane kerkuar punonjes te specializuar dhe te certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën,**

Konkretisht jane kerkuar

- **3 Hidraulike**, te cilet sic parashtruam me lart jane te nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve ku punimet hidraulike zene pjesen me te konsidderueshme te punimeve te kontrates.
- **3 Teknike ndertimi dhe muratore**, qe do jene te nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. duke patur parasysh punime

ndertimore qe do te kryhen si: ne ndertimin e mureve me palankola të përkohshme ose të përhershme, muret e soletave prej betoni , etj..

-3 (tre) punonjes te specializuar per shtrim pllaka Referuar Listës Shqiptare të Profesioneve, shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to , sipërfaqet e tjera me pllaka trotuari ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e me pllaka trotuari pjeset qe do nderhyet per vendosjen e tubacionit etj. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e tyre AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 3 (tre) **punonjes te specializuar per shtrim pllaka** . Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*) numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht.

-3 (tre) punonjes te specializuar per shtrim asfalti, Referuar Listës Shqiptare të Profesioneve, shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to , sipërfaqet e shtrimit te asfaltit ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin asfaltit pjeset qe do nderhyet per vendosjen e tubacionit etj. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e tyre AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 3 (tre) **punonjes te specializuar per shtrim asfalti**. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*) numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht

- Eshte kerkuar 1 (një) punonjes i certifikuar me deshmi trajnimi si “Përgjegjës per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune” .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. **Çdo punëdhënës**

zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjes së shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme **për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.** Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

g. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre)muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këto qëllime. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, kontratë noteriale pune (*të vlefshme*), Urdhër mjeku, Diplomë, CV, dhe librezë pune. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomike pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.692, datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “*Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë*” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003), njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nenshkruaje kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

2.3.4. Licensat

a. Operatori Ekonomik të ketë Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

2.3.5. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia	Statusi
1.	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 22 ton	4 (Kater) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
2.	Buldozer	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
3.	Kamioncine me kapacitet mbajtes (3-4 ton)	3 (tre) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
4.	Kamion me Vinç	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
5.	Fadrome kove perpara dhe mbrapa	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
6.	Rimorkiator per transportin e makinerive	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
7.	Eskavator me goma	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
8.	Eskavator me zinxhir	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
9.	Eskavator pajisur me pince dhe me çekic	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
10.	Minieskavator	4 (kater) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
11.	Autobitumatrice	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
12.	Autobetoniere	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
13.	Motobetoniere kapacitet min 0.5 m3	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
14.	Autopompe Betoni	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
15.	Autobot uji me sprucator (min 5000 litra)	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
16.	Rrul ngjeshes gome-hekur mbi 10 ton	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
17.	Rul gome –gome per asfaltime mbi 14 ton	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
18.	Rrule vibrues Gome-Hekur mbi 18 ton	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
19.	Rrul me kompresor dhe vibrim min 10 ton	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
20.	Asfaltshtruese	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
21.	Sharre per Prerje asfalti	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
22.	Motovibrator	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>

23.	Minifadrom	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
24.	Korrse/prerese bimesh	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
25.	Batipal	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
26.	Prerese dhe kthyese hekuri	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
27.	Aparatë për ngjitje tubash	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
28.	Gjenerator minimumi 50KVA	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
29.	Pirun ngrites	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
30.	Grejder	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
31.	Pajisje Topografike GPS	2 (dy) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
32.	Kompresor	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
33.	Gazogjen	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
34.	Rimorkiator -Terheqes	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
35.	Makineri frezuese asfalti	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
36.	Semafor sinjalistike per punime ne rruge	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>
37.	Zyre mobile (e levishme) kantieri	1 (nje) cope	<i>në pronësi ose me qira</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kerkesave te VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 ”Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jeleke fosforoshente minimumi 60 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 50 copë

Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne rregjistrimin e tij, plus certifikaten e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerases te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit- blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per mjetet e transportit per mallra te klasifikuara sipas legjislacionit ne fuqi te rrezikshme (Autobitumatrice) duhet te paraqesin certifikaten per transport mallrash te rrezikshem leshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)

Shenim: Per mjetin "Rimorkiator per transportin e makinerive", ne rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni certifikate pronesie / kontrate qeraje, nga autoriteti kontraktor do te pranohet edhe dokumenti kontrate huaperdorje.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje **referuar preventivit të punimeve** janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njesia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomik të disponojnë mjetet e pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Sipas specifikimeve teknike

Do të sigurohen makinerite e nevojshme të germimit, ngritjes, transportit dhe të gjitha makineritë e tjera të nevojshme për tu marrë me çdo klasë materiali dhe germimi për punimet do të kryhet me një gjerësi, gjatësi, thellësi, drejtim dhe pjerrësi të tillë si ato të specifikuara ose të treguara në Projektin Perfundimtar.

Makinerite kamiona dhe kamioncina janë kërkuar për transportin e materialeve që do të dalin gjatë germimeve sipas kërkesave në preventive, ku ka germime në volume të mëdha dhe transport dheu me auto deri në 5 km në volume 23735 m³

Gjithashtu ky proces do të vazhdojë me mbushje ngjeshje, drenazhime dhe largim të ujerave etj

Eskavator me goma për germim dheu është kërkuar sipas kërkesave të preventivit për germim dheu.

Makinerite për prerje asfalti janë kërkuar sipas specifikimeve teknike se ku përcaktohet shtresat e asfaltit duhet të priten me sharrë. Punimi konsiston në prerje vertikale me sharrë të asfaltit ekzistues për të lehtësuar heqjen e shtresave bituminoze. Ai duhet të kryhet me pajisje të veçanta dhe punëtori të specializuar.

Autobitumatrice është kërkuar referuar specifikimeve teknike ku parashikohet Makinerite e grumbullimit dhe përzierjes së materialeve bituminoze të ngritura në kantier, për punimet në asfalt dhe shtresave të binderit dhe punimeve në shtresat asfalto beton.

Makinerite Vibrator Betoni Makineri Prerese Betoni pompe Uji janë kërkuar duke patur parasysh punimet në beton si puseta betoni . Pajisja vibrator Betoni do të

perdoret per hedhjen dhe ngjeshjen e betonit si dhe per rikuperimin e palankolave prej betoni te armuar.

Eshte kerkuar Makineri per frezim asfaltine rruge te asfaltuara pasi kjo makineri do te jete e domosdoshme per hapjen e kanaleve ne te cilatdo te shtrohet dhe do te kaloje tubacioni KUZ.

1	Kompresor	cope	1	Kjo pajisje eshte e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejn autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi per pajisjet sipas specifikave
2	Zyre mobile	cope	1	Nisur nga volumi i madh i ndertimit dhe per manaxhimit sa me efikas te dokumentacionit teknik si dhe prania e stafit inxhinierik ne objekt, përdorimi i të paktën nje kontenier ndertimi stacionar është i domosdoshëm
3	Gjenerator minimumi 50KVA	cope	2	Keto pajisje janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi per pajisjet sipas specifikave
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3 - 4 Ton	cope	3	Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasi të, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamionçina me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Për këtë qëllim janë kërkuar tre kamionçina, përkatësisht dy me kapacitet mbajtës 3-4Ton. Ky numër është minimumi i nevojshëm në raport me vëllimin e materialeve, duke mbajtur në konsideratë se punimet do të zhvillohen në periudha të caktuara në të gjitha vëllimet e ndërtesës.
5	Autobetoniere	cope	1	Duke qenë se transportimi i betonit, të pregatitur në fabrikë kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia shumë e madhe e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv, nevojitet minimalisht një autobetoniere .
7	Autopompe Betoni	cope	1	Ky mjet është i domosdoshëm për ngritjen e betonit të freskët sipas planit të organizimit dhe teknologjisë përkatëse në punimet për realizimn e elementëve prej betoni të armuar , është kërkesë minimale.
8	Eskavator me goma	cope	1	Referuar preventivit të punimeve, paragrafi 1,
9	Eskavator me zinxhir	cope	1	Punime gërmimi e transport dheu, gërmimi i dherave parashikohet të kryhet me eskavator me
10	Eskavator pajisur me pinc dhe	cope	1	

	cekic			zinxhir 0.5 m ³ dhe eskavator me goma. Mbështetur në sasinë totale të dherave dhe grafikun e punimeve,
11	Buldozer	cope	1	Për punime të mbushjes, gërryerjes, sheshimit dhe shtyrjes se dheut eshte kerkuar minimalisht nje buldozer.
12	Fadrom me goma me kove para mbrapa	cope	2	Për punime të mbushjes dhe zhvendosjes së dherave brenda kantierit, nevojitet përdorimi i minimalisht dy fadromave me kovë para dhe mbrapa për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet. Referuar grafikut të punimeve do të realizohen të gjitha punimet e gërmimeve.
13	Minifadrom	cope	1	Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të dheut, për punime të mbushjes dhe zhvendosjes së dherave brenda kantierit, nevojitet përdorimi i minimalisht 1 minifadrove.
14	Minieskavator	cope	4	Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gërmimeve te dheut, nevojitet përdorimi i minimalisht një minieskavatori për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet. Referuar grafikut të punimeve brenda pese muajve të parë do të realizohen të gjitha punimet e gërmimeve.
15	Grejder	cope	1	Për punime e sheshimit te sipërfaqes se ndertimit dhe shtyrjes se dheut eshte kerkuar minimalisht nje grejder
16	Autobot uji	cope	1	Kjo makineri do të përdoret në momentet e ndërtimit të shtresave të ndryshme që do të realizohen në kantier. Ajo është e domosdoshme për të siguruar ujin e nevojshëm në materialet që do të ngjeshen, gjithashtu për të siguruar ujin e nevojshëm për proceset teknologjike në raste avarie të sistemit të furnizimit me ujë. Kërkesa për nje makineri të tille kushtëzohet nga vëllimi i madh i punimeve dhe fakti se në tre vëllimet e ndërtesës, do të punohet njëkohësisht.
17	Asfaltoshtruese	cope	1	Ne preventive jane parashikuar shtrese asfaltobetoni dhe binderi 6030 m2 ,makineri te tille eshte minimaliste
18	Auto bitumatrice	cope	1	Ne preventive jane parashikuar shtrese asfaltobetoni dhe binderi 6030 m2 ,makineri te tille eshte minimaliste
19	Rrul ngjeshes gome-hekur mbi 10 ton Rrul me kompresor dhe vibrim min 10 ton Rrule vibrues Gome-Hekur mbi 18 ton	cope	3	Për të kryer punimet e ngjeshjes së shtresave në sheshin e ndërtimit, mbështetur në preventivin e punimeve është kërkuar disponimi i të paktën një ruli
20	Rul gome –gome per asfaltime	cope	1	Ne preventive jane parashikuar punime te shtrese binderi me granili dhe shtrese cakulli. Kerkesa per nje makineri te tille eshte minimaliste

Në lidhje me kriterin për disponimin e makineri pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se, referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i pajisjeve dhe aparaturave të tilla.

Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi.

Ndersa mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier".

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

a- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, Fabrika prodhimi i inerteve të pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Furnizimi të ketë status aktiv në QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet të paraqesë të pakten njëri nga anëtarët e grupit).

b- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, Fabrik Asfalti të pajisura me (Leje mjedisore tipi B, QKL Kodi III.1.B) si dhe e pajisur me ISO 9001:2015 mbi certifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi si dhe të shoqërohet me raport Monitorimi nga Organet të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të pakten 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Mbeshtetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturë 155°C DERI NE 170 C°, Fabrika /Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jete në një distancë jo më të largët se 60 km nga vendodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domozdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se 140 C°, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M nr.628 datë 15.07.2015, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Furnizimi të ketë status aktiv në QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet të paraqesë të pakten njëri nga anëtarët e grupit).

Në rastet se Operatori Ekonomik ofertuesi ka kontratë furnizimi materiale duhet të paraqitet dokumentacioni i lartpërmendur shoqëruar me kontratën materiale të furnizimit (e vlefshme për gjatë gjithë afatit të kësaj kontrate) si dhe me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jete e përshkruar emërtimin i objektit që prokurimet të sigurohet sasi dhe afati i furnizimit .

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronësi apo me qera i këtyre fabrikave është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofririn tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të përdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet në mënyrë të ngushtë edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pasi sasia e produkteve që do të përdoren është e konsiderueshme.

b-

2.3.9 Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes se punimeve eshte 12 muaj sipas Grafikut te Punimeve te publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte bere ne baze te nenit 15 pika 3/a të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “*Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;*”

Njësia e prokurimit referuar grafikut te punimeve ku parashikohej dhe afati i kryerjes së punimeve, vendosi që afati i punimeve të jete 12 muaj i vlerësuar si nje afati mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqeria projektuese percjelle ne Bashkine Berat dhe ne autoritetin kontraktor per publikim, për punimet objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike te percjella plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë: Data: **27.05.2024** Ora **11:00**
në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.